



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 806 / Prot.
16

Patos, më 25 / 04 / 2023

PROCESVERBALI I TAKIMIT 13 prill 2023

Vendi: "Njësia Administrative Ruzhdie "

Ora e fillimit : 10:00

Ora e mbarimit : 11:00

Tema E Konsultimit: " Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18; Ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin Publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52 ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"; Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për Konsultimin Publik", si dhe VKB-së nr. 94 datë 19.12.2022 Mbi Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe Prjekt Buxhetit Vjetor për vitin 2024.

Pjesëmarrës: Administrator i Njesisë Ruzhdie z.Agim Mesutaj, *Specialist i Drejtorisë së Financës në bashki* z.Andi Kola, *Koordinatore e Konsultimit Publik* znj.Suzana Hysenaj, *Koordinatore e të drejtës për Informim* znj. Luizaura gropa, *Rreth 15 pjesëmarrës (Kryetarë të fshatrave, Banorë dhe fermerë të njësisë Administrative Ruzhdie)*

Takimin hapet nga Administrator i Njësisë Ruzhdie z. Agim Mesutaj: unë ju falenderoj për pjesëmarrjen pasi keni lenë gjithë punët tuaja për të ardur sot në këtë deëgjesë publike lidhur mbi prioritetet tuaja për buxhetin afatmesëm, prandaj kërkojmë mendimin tuaj se ku Bashkia mund t'i adresojë fondet për shërbime, investime apo dhe funksione të tjera. Ndaj presim mendimin tuaj pavarësisht se unë si administrator i di fort mirë hallet dhe problemet tuaja por ligji na detyron që të bëjmë këto takime me qëllim marrjen mendimeve tuaja se ku doni të investohet nga bashkia por si fillim punonjësi e financës do të na paraqesë një matërial mbi investimet e bashkisë në njësinë Ruzhdie më pas gjithsecili është i lutur të japi mendimin e tij . Fjala është për ju.




**Administrator i Njësisë Ruzhdie
z. Agim Mesutaj:**

Degjesë publike me temë:

*“ Marrja e kërkesave prioritare
për hartimin e programit buxhetor
afatmesëm 2024-2026 dhe projekt
buxhetit për vitin 2024*

Specialist i Financës pranë Bashkisë z. Andi Kola – të falenderit, ne jemi në fazën e parë të marrjes së kërkesave për buxhetin e vitit 2023 dhe atij aftatmesëm 2024-2026. Por përpara se të marrim kërkesat tuaja për buxhëtin afatmesëm unë do paraqesë listën e investimeve dhe ndërhyrjeve që bashkia ka parashikuar për të investuar gjatë këtij viti kalendarik



**Specialist i Financës pranë
Bashkisë z. Andi Kola**

Degjesë publike me temë:

*“ Marrja e kërkesave prioritare
për hartimin e programit
buxhetor afatmesëm 2024-2026
dhe projekt buxhetit për vitin
2024*

Specialist i Financës pranë Bashkisë z. Andi Kola – liston investimet e parashikuara për njësinë Ruzhdie për vitin 2023

Kryetar i fshatit Siqecë z. Myftar Soraj – ne kemi bërë dëgjesa ku janë marrë parasysh problemet në fshatrat tona të cilat disa janë pasqyuar dhe disa jo në buxhet, pasi kjo padyshim varet dhe nga buxheti që i vjen Bashkisë.

Lidhur mbi fshatin Siqesë problemi kryesor është mospasja e ujit të pijshëm jo vetëm në fshat por për të gjithë Ruzhdien por me ujësjellësin shpresojmë që kjo çështje të zgjidhet. Problemi që e kam ngritur dhe herë të tjera është problemi i azhорimit të tokës dhe mos pasja e certifikatës së pronësisë sjell shumë pengesa pasi si fermerë nuk aplikojmë dot në asnjë skemë për fermerët. Në lagjen “Xhepaj” është shumë problem me rrugët pasi nuk kalon dot as zjarrëfiksja dhe kërkoj zgjerimin dhe shtrimin e saj gjithashtu kërkoj që të ndërhyet për shtrimin dhe hapjen e rrugëve të reja për në parcelat e tokave bujqësore.



**Kryetar i fshatit Siqecë z.
Myftar Soraj**

Degjesë publike me temë:

*“ Marrja e kërkesave prioritare
për hartimin e programit
buxhetor afatmesëm 2024-2026
dhe projekt buxhetit për vitin
2024*

Kryetar i fshatit Ruzhdie z.Sako Myftaraj – për fshatin Ruzhdie është e disajta herë që kërkojmë shtrim të rrugëve në brendësi të fshatit ; shtrim dhe haje të rrugëve të reja të parcelave të tokave bujqësore; negociim nga ana e Bashkisë me hipotekën për azhорnim të tokave bujqësore më qëllim marrjen e certifikatave të pronësisë.



**Kryetar i fshatit Ruzhdie
z.Sako Myftaraj**

Degjesë publike me temë:

*“ Marrja e kërkesave
prioritare për hartimin e
programit buxhetor afatmesëm
2024-2026 dhe projekt
buxhetit për vitin 2024*

Banor i fshatit Ruzhdie z. Alvaro Fiqiriu - Kryetari i fshatit tha problemet më kryesore unë dua të ngre një problem që ka të bëjë me një shtyllë elektrike e cila duhet hequr ose ti bëhet një kondra mbështetëse pasi përbën rrezik për banorët dhe vendosjen e një transformatori pasi nuk ka tension të lartë në banesa. Gjithashtu kërkoj të ndërhyet në lagjen Myftaraj rruga e qendrës shëndetësore që të bëhet një unazë e vogël e lagjes dhe nuk shkon më shumë se 300 m.




Banor i fshatit Ruzhdie z. Alvaro Fiqiriu

Degjesë publike me temë:

“ Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024

Banor i fshatit drenie z. Tefik Lazaj: - unë banoj në fshatin Drenie dhe nuk kemi as rrugë dhe as ujë të pishëm ndaj bashkia të ndërhyjë për hapjet e rrugëve të fshatit. Rruga nga Mejkami deri te Mitat Zorbaj kërkon ndërhyrje urgjente.



Banor i fshatit Drenie z. Tefik Lazaj:


Degjesë publike me temë:

“ Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024

Administrator i Njesisë Ruzhdie z. Agim Mesutaj:- duke qenë në cilësinë e administratirit dhe fakti se disa kryetarë fshatrash nuk kanë ardhur dua të ngre disa kërkesa që në gjykimin tim kërkojnë ndërhyrje nga ana e bashkisë.

Për fshati Gjinoqarë kërkoj shtrim të rrugëve me asfaltobeton me lagjen “Manxharaj” dhe lagjen “Ymeraj” gjithashtu dhe ruga Oficinë-Kasnicë kërkon ndërhyrje urgjente

Kërkoj të bëhet ndërhyrje për mbushje me inerte të segmentin rrugor Mashkullorë – Visokë dhe Gjinoqarë -Ngrece. Vazhdimi i investimit të rrugës Siqecë -drenie si dhe ndërhyrje në rrugët e parcelave me kusht që makineritë të mos largohen pa mbaruar i gjithë blloku ku do të hapen rrigët pasi krijon konflikt me banorët



**Administrator i Njesisë Ruzhdie
z. Agim Mesutaj:-
Degjesë publike me temë:**

***“ Marrja e kërkesave prioritare
për hartimin e programit
buxhetor afatmesëm 2024-2026
dhe projekt buxhetit për vitin
2024***

Banor i fshatit Ruzhdie z. Alvaro Fiqiriu - jam dakord me atë që tha Agimi lidhur mbi hapjen e rrugëve të lagjeve, nëse janë për tu hapur dhjetë rrugë të përfundojnë ato pastaj i con makineritë në lagje tjetër

Administrator i Njesisë Ruzhdie z. Agim Mesutaj:- – padyshim që cdo sygjërim i juaji është tepër i vyer për bashkinë. ndonjë kërkesë tjetër? Me qenë se jo, e deklaroj këtë seancë të parë dëgjimore për Buxhetin Afat mesëm 2024-2026 të mbyllur.

Konceptoi:

Koordinator i Konsultimit Publik

Suzana Hysenaj

Pranoi: Sekretar i Këshillit

Balil Balili



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Ruzhdie më, 13.04.2023

LISTË PREZENCË PJESËMARRJE NË DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:
“MARRJEN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PBA-SË 2024-2026 DHE BUXHETIT TË VITIT 2024”

Nr	Emër	Mbiemër	Njësia /Fshati	Profesioni/ Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1	Khemië Masoj		Ruzhdie	Spec. Sh. Social.	0695268127	
2	Olivera Gropa		B. Patos	Korid. info. publik	0688400610	
3	Andi Kola		B. Patos	SP Finance /Buxhëk	0676655702	
4	Stefir Karon		'Zemmer'	Qytetar	—	
5	Suzana Hyseny		B. Patos	Koord. Konduktim	0684881460	
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008” Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 “Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore” Të dhënat personale, të mbledhura për qëllime të tjera, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale përdoret vetëm për qëllime gazetare, literare ose artistike. Përfshihet nga zbatimin nenet 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Ruzhdiq më, 13.04.2023

LISTË PREZENCË PJESËMARRJE NË DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:
“MARRJEN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PBA-SË 2024-2026 DHE BUXHETIT TË VITIT 2024”

Nr	Emër	Mbiemër	Njësia /Fshati	Profesioni/ Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1	METAR	SORBAJ	Ruzhdiq-Siçez	KRYETAR ZSHARRI	0682453149	
2	Jaqi	Solmaj	Siqec	Kermer	—	
3	ALVARO	FIGURIU	Ruzhdiq	FERRER	0692405993	
4	NOZMI	MËTAKRI	Ruzhdiq	FERRIER	0693817469	
5	Mit	Konca	Ruzhdiq	FERRIER	0696653888	
6	Ahmet	Ushaj	Ruzhdiq	FERRIER	0696153610	
7	Asterit	MËTAKRI	Ruzhdiq	FERRIER	—	
8	SOKO	MËTAKRI	Ruzhdiq	FERRIER	0699781493	
9	Faqic	AGJAJ	Siqec	FERRIER	—	
10	JADIL	LAZAJ	Drenovë	FERRIER	0693918331	
11	ARMAN	VEJTI	Ruzhdiq	AMISTORRI	0682036282	
12	ANSEL	AGJAJ	R. Patos	COMMUNICACION	06968773398	
13						

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008” Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 “Përpunimi për qërkime shkencore dhe statistikore” Të dhënat personale, të mbledhura për qëllime të kërkimit shkencor ose statistik, duhet të ruhen në mënyrë të sigurtë dhe të kufizuara në akses, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara për të identifikuar individin nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale për detyra të tilla për qëllime gazetarie, literare ose artistike. Përpunimi i të dhënave personale, sipas kësaj dispozitive, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes nga zbatimi i nenit 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas kësaj dispozitive, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Ruzhdie më, 13.04.2023

LISTË PREZENCË PJESËMARRJE NË DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:
“MARRJEN E KËRKESAVE PRIORITYARE PËR HARTIMIN E PBA-SË 2024-2026 DHE BUXHETIT TË VITIT 2024”

Nr	Emër	Mbiemër	Njësia /Fshati	Profesioni/ Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008” Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 “Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore” Të dhënat personale, të mbledhura për qëllime të tjera, mund të përpunohen me tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale përdoret vetëm për qëllime gazetarie, literare ose artistike. Përgjashohen nga zbatimin nenet 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes.